

V E N D I M
Nr.127, datë 25.3.1994

PËR TREGUN VALUTOR

Me propozimin e Bankës së Shqipërisë dhe të Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I :

1. Në Republikën e Shqipërisë zbatohet regjimi luhatës i kursit të këmbimit të lekut ndaj monedhave të tjera. Kursi i këmbimit të lekut përcaktohet në bazë të veprimeve në treg.
2. Në territorin e Republikës së Shqipërisë si mjet pagese shërben leku. Bëjnë përjashtim dyqanet e valutës në pikat kufitare dhe në aeroport. Për raste të veçanta, me miratim të Bankës së Shqipërisë, të lejohen veprime në valutë për subjekte të ndryshme brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.
3. Personat fizikë e juridikë, rezidentë në territorin e republikës së Shqipërisë, lejohen të hapin dhe të mbajnë llogari në monedhë të huaj pranë bankave dhe institucioneve financiare jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë vetëm me miratimin e Bankës së Shqipërisë.
4. Valutat e arkëtuara në monedhë të huaj të ministrive, institucioneve të tjera qendrore, organeve të pushtetit lokal dhe institucioneve të tjera buxhetore i shiten bankës së Shqipërisë.
- Nevojat e institucioneve të sipërme për monedhë të huaj plotësohen duke i blerë ato në Bankën e Shqipërisë ose në bankat e nivelit të dytë. Kursi i këmbimit që zbatohet për shitje a blerje, do të jetë kursi i tregut në kohën e veprimit.
5. Banka e Shqipërisë çdo ditë llogarit dhe njofton kursin e lekut në tregun e brendshëm valutor.
6. Tregu i këmbimeve valutore në Republikën e Shqipërisë rregullohet me rregullore të veanta të nxjerra nga Banka e Shqipërisë.
7. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.288, datë 1.7.1992 "Për sistemin e tregut valutor", si çdo dispozitë tjetër që bie në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohet.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYTARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi